

## ADEM DEMA PËR ADEM DEMAÇIN

Bashkim MUSLIU  
USHAF

Punim studimor

**Përmbajtje e shkurtër:** Punimi trajton njëren prej veprave më të mira të Adem Demaçit: romanin autobiografik *Dashuria kuantike e Filanit*, në të cilën, duke rrëfyer me “kapërcime”, autori mbulon një kohë rreth gjysmëshekullore. Ngjarjet, situatat, mjedisi, personazhet janë të vërteta, natyrisht të plotësuara me tisin e fiksionit.

Autori është dëshmitar dhe pjesëmarrës i ngjarjeve, prandaj vlera dokumentare e librit është e një rëndësie të veçantë. Adem Demaçi dëshmon përmes rrëfimit, por edhe përmes dialogëve e përsiatjeve.

Në këtë punim trajtohen tematika, dialogu, personazhet, vlera dëshmuese dhe përgjithësuese e romanit.

Adem Demaçi edhe kësaj radhe, pavarësisht se shkruan roman autobiografik, duke rrëfyer për ngjarjet dhe situatat në të cilat e ka shpënë jeta, jep imazhin dhe atmosferën e një kohe jo të zakonshme në historinë e popullit të tij.

**Fjalë çelës:** autobiografi, personazh, dëshmi, strukturë

*Dashuria kuantike e filanit*, pavarësisht se është roman autobiografik, më shumë është “biografi” e një kohe. Situatat që evokohen nga personazhi rrëfimtari aq sa zbulojnë rrëfimtarin, po aq janë dëshmi e kohës. Autori, duke rrëfyer për një kohë, nuk ka për qëllim të flasë për vetveten. Përkundrazi, duke rrëfyer për veten flet për një kohë dramatike. Biografia e Filanit, ballafaqimi i tij me UDB-në, kapërcen individin: bëhet simbol i të gjithë të panështruarve.

Pse dashuria kuantike? Kryepersonazhi ka një dashuri kozmike: dashurinë për vendin e tij, për lirinë, për njeriun. Apo, siç e thotë Filani, është një dashuri shpirtërore dhe jo dashuri për trupin. Është dashuri përtej mundësive të trupit; është dashuri ideale, sepse, në fund të fundit, e gjithë jeta e autorit udhëhiqet nga një ideal.

**Tema.** Jeta dhe fati i Filanit simbolikisht shpërfaqin fatin e shqiptarëve të mbetur jashtë Shqipërisë. Prandaj, në romanin *Dashuria kuantike e Filanit* Adem Demaçi për zgjedh situata që shpërfaqin jo vetëm karakterin e personazhit, por edhe atmosferën e përgjithshme të kohës dhe fatin e popullit në kohë dramatike. ” Sikur jeta ime dhe jeta e familjes sime të mos ishte për shumëçka tipike për jetën e shumicës dërrmuese të popullit tonë, që ende po palavitet ta fitojë lirinë, unë nuk do ta bëja këtë rrëfim. Prandaj të rrëfej jetën time e të familjes sime të shohësh fenomenologjinë e zhvillimit tim dhe të shumicës së shqiptarëve të robëruar”.<sup>1</sup>

Kështu, romani tematizon jetën e Filanit dhe të popullit të tij në rrethana ekzistenciale.

**Struktura.** Romani, në aspektin strukturor, ndahet në dy pjesë: e para, nëntë letra elektronike që i drejtohen Dardhës; e dyta, tregimet e shkurta. Pjesët nuk vijnë njëra pas tjetrës, por janë të ndërthurura: pas disa tregimeve ndërfitet një letër që i drejtohet Dardhës. Në përgjithësi letrat lidhen me të tashmen dhe të ardhmen, kurse tregimet, me përjashtim të tri të parave, evokojnë të kaluarën e Filanit.

*Dashuria kuantike e Filanit* ndërtohet nga tregime të shkurta, të cilat ndonjëherë janë vazhdimësi e njëri-tjetrit, por, në të shumtën e herëve, nuk lidhen drejtpërdrejt. Struktura përcaktohet nga situatat më të rëndësishme, të cilat i përzgjedh pesha e tyre dhe kujtesa e Filanit. Pothuaj secili tregim jep një pamje, një atmosferë dhe, së bashku, e përplotësojnë biografinë e Filanit, e cila shumë lehtë mund të ekranizohet.

Për shkak se Filani ka kaluar situata që i dimë të gjithë, mund të themi se *Dashuria kuantike e Filanit* më mirë dhe më çiltër se çdo roman tjetër e rrëfen jetën në Kosovën e pasluftës së Dytë Botërore.

**Rrëfimi.** Autori rrëfimtari është kryepersonazhi. Ai është, siç e thotë vetë, “aktor dhe dëshmitar okular i ngjarjeve”.

Pjesa kryesore e romanit përbëhet nga tregimet, të cilat përplotësohen me letrat elektronike. Tregimet, sipas autorit, përbëjnë rrëfimin kryesor, ndërsa letrat rrëfimin anësor.

<sup>1</sup> Adem Demaçi, *Dashuria kuantike e Filanit*, “Gjon Buzuku”, Prishtinë, 2007, f. 7.

Në letrat elektronike rrëfimi është personal, ndërkaq në tregimet autori ka për qëllim që t'u qëndrojë sa më besnik të vërtetave që i rrëfen.

Rrëfimi është konciz dhe pa hollësi. Kur Dardha kërkon që letrat të kenë më shumë sqarime, Filani i përgjigjet: “ E dashur unë po rrëfej për ngjarjet para pesëdhjetë vjetësh dhe për atë që dija në atë kohë... ”<sup>2</sup> Duke iu shmangur hollësive Demaçi shton objektivitetin dhe dendurinë e rrëfimit.

Rrëfimi ka një referent: të dashurën e rrëfimitarit, Dardhën; ka një qëllim: Filani do ta shpërfaqë thelbin e tij, filozofinë dhe krajatat e tij para Dardhës në mënyrë që ajo ta njohë njeriun me të cilin është në lidhje. Si i tillë rrëfimi është thellësisht personal. Megjithëkëtë, kur Filani përsiat, rrëfimi karakterizohet nga diskursi filozofik, ndërsa kur rrëfen histori të caktuara, merr ngjyrim eseistik.

Filani, duke mos pasur qëllim ta bindë Dardhën që të dashurohet, ia shton objektivitetin rrëfimit. Përkundrazi, ai e vë në mëdyshje duke i thënë se fizikisht, për shkak të dallimit të theksuar në moshë, nuk ishin për njëritjetrin. Rast i rrallë edhe në letërsi, e lëre më në jetë, kur i dashuruari i jep argumente të dashurës se pse nuk do të duhej të ishin bashkë.

Autori, ndonjëherë, pothuaj telegrafikisht jep një ngjarje, një situatë duke u përqendruar në momentin kryesor. “Unë do të ndalem vetëm nëpër disa nga situatat më të forta, të cilat më janë thadruar fuqishëm në shpirtin e zemrën time dhe të cilat spikaten në vazhden e jetës sime të derisotme... ”<sup>3</sup> Rrëfimi i “kujtimeve me kërcime” jep fotografinë kryesore të ngjarjes. Ajsbergun e plotëson lexuesi. Ndoshta nuk ka roman tjetër në letërsinë shqipe, në të cilin lexuesi ka më shumë “punë” për ta plotësuar rrëfimin. Me pak tekst lihet të kuptohet shumë; me thelbin e situatave jepet thelbi i jetës fizike dhe shpirtërore të Filanit. Tregimet janë kuantet kryesore të jetës së tij.

Filani është narrator i romanit, por ka raste kur këtë rol e merr ndonjë personazh episodik. Rrëfimi i personazheve ndërfitet natyrshëm në rrëfimin e Filanit duke e përplotësuar funksionin dëshmues.

*Dashuria kuantike e Filanit* përfshin një kohë prej pesëdhjetë vjetësh. Tri tregimet e para lidhen me aktualitetin, jetën e Filanit në dhomën e hotelit, me mendimet, meditimet dhe dialogët me personin e papranishëm. Tregimet e tjera e shpijnë kujtesën e Filanit në fëmijërinë e tij, për të vazhduar me “ kërcime ” rrëfimin për jetën.

<sup>2</sup> Po aty, f. 47.

<sup>3</sup> Po aty, f.18.

Romani nuk është i vëllimshëm, por mbulon rreth gjysmë shekulli kohë. Konceptimi i tillë i kohës sikur ka imponuar qoftë strukturën, qoftë mënyrën e rrëfimit. Mund të thuhet se Adem Demaçi e ka gjetur formën më të mirë, për të thënë shumë me pak tekst.

**Dialogu.** Dialogët karakterizojnë një numër të konsiderueshëm të tregimeve. Kemi dialogë filozofikë, që janë monologë të dialogëzuar. Madje, sipas K. Radogushit, "Ajo që e bën të veçantë stilin e këtij romani është dialogiciteti i brendshëm".<sup>4</sup>

“Hyra në dialog me vetveten:

Nuk e ftova atë, Dardhën fizike, por e ftova Dardhën kuantike. Dhe, si e tillë, ajo më takon dhe, si i këtillë edhe unë i takoj asaj. A nuk jam edhe vetë pjesë e gjithësisë kuantike”<sup>5</sup>.

Lloj tjetër i dialogut është ai që zhvillohet me personin e papranishëm që në të vërtetë është rikujtim i dialogut që zhvillohet në mendjen e Filanit. Më të shpeshtë janë dialogët që ai zhvillon me të tjerët që, në të shumtën e herëve, kanë formën pyetje-përgjigje, si dialogët me të moshuarit, me shokët, me hetuesit etj.

Dialogët më fuqishëm se sa rrëfimi karakterizojnë personazhin dhe i japin dinamikë rrëfimit.

**Përshkrimi.** Tregimi hyrës është pothuajse tërësisht përshkrim. Nuk është rastësi pse pikërisht tregimi i parë përshkruan një ditë me stuhi, me rrebeshe, sepse shpirti i Filanit do të rrëfejë rrebeshet e jetës së tij, stuhitë që kishin goditur popullin e tij. Natyra dhe shpirti i tij duan të çlirohen; duan të nxjerrin bubullimat që mbajnë brenda. E bubullimat mund të verbojnë sytë e njerëzve, por megjithatë ato nxjerrin dritë.

Filani përshkruan edhe ditën e burgosjes së parë (19 nëntor 1958): “Ditë e mërrolur, e ngrysur, me re të trasha e të sterruara, të cilat, me bar-kun e lëshuar, vetëm që nuk e preknin tokën e ftohtë”<sup>6</sup>. Përshkrimet e rralla janë në funksion të shpërfaqjes së përjetimeve të ngjarjeve nga personazhi, ndërsa përshkrimet e dhomave të burgut na vënë pas syve hapësirën ku kanë jetuar të burgosurit; mënyrën se si kanë jetuar, vështirësitë me të cilat janë ballafaquar. Kjo hapësirë krijon edhe idenë se sa ata kanë vuajtur.

<sup>4</sup> Kadrush, Radogoshi, *Roman epistolary, i personazhit apo enciklopedi e shpirtit, në Romani “Gjarpijt e gjakut”* (Artikuj të zgjedhur letrarë nga Abdullah Konushevc), Nositi, Prishtinë, 2011. f. 137.

<sup>5</sup> Adem Demaçi, *Dashuria kuantike e Filanit*, “Gjon Buzuku”, Prishtinë, 2007, f. 13.

<sup>6</sup> Po aty, f. 93.

Me përshkrimet, rrëfimin dhe dialogët, *Dashuria kuantike e Filanit* paraqet imazhin më të plotë dhe më besnik të Kosovës pas vitit 1945.

**Funksioni dëshmues.** Në *Dashuria kuantike e Filanit* rrëfihen disa nga ngjarjet dhe situatat më të rëndësishme të njerit prej personaliteteve më të rëndësishme të popullit shqiptar: Adem Demaçit. Duke qenë se ai jo vetëm përfaqësoi, por ishte edhe simbol i përpjekjeve tona për liri; simbol i qëndresës, lirisë, parimësisë, stoicizmit; simbol i njeriut që nuk bën kompromis me të vërtetën, atëherë funksioni dëshmues fiton vlerë të veçantë.

Romani është dëshmi e vuajtjeve të shqiptarëve të mbetur jashtë shtetit amë; është dëshmi për ata që e pësuan për shkak se nuk u pajtuan me ndarjen e Shqipërisë; është dëshmi për një kohë dhe për përfaqësuesin gjigand që e nderoi këtë kohë.

Në *Dashuria kuantike e Filanit* ndeshim edhe shumë emra pothuaj të harruar, të cilët bënë historinë e një kohe, historinë e përpjekjeve për liri, si: Shaban Shala, Rexhep Latifi, Burhan Pasholli, Emrush Myftari, Ramin Cërnica, Halim Spahiu, Xhemil Fluki, Omer Çerkezi, Muhamet Krasniqi, Adem Velikinca, Xheladin Hana, Njazi Maloku, Sedat Dibra etj. etj.

Përveç emrave të shumtë që defilojnë para syve të lexuesit, tregime të caktuara lidhen me personazhe të cilat në një mënyrë simbolizojnë një karakter të caktuar: Maliqi, simbolizon shpirtin e panënshtuar; Zekeria Rexha, mësuesin që frymëzon nxënësit edhe në rrethana të rrezikshme; Idriz Ajeti, profesorin që nuk flet drejtpërdrejt, por është në anën e nxënësve; Velku, gardianin e burgut; Kallugjeroviqi, prokurorin etj.

Pothuajse secila ngjarje plotëson pamjen e kohës dhe karakterizon Filanin duke dhënë dëshmi për një kohë. Ja disa nga ngjarjet në të cilat na kthen kujtesa e tij:

- Bastisjet e shtëpive nga partizanët-çetnikë që hyjnë në Prishtinë, me ç'rast e maltretojnë dhe arrestojnë të vëllain e Filanit, Maliqin. Qëndrimi burrëror i Maliqit lë gjurmë të pashlyera në mendjen dhe shpirtin e tij. Kështu i vëllai bëhet shpirti që e forcon Filanin.

- Pushkatimet e shqiptarëve në "Strelishtë".

- Takimin e shkrimtarëve në të cilin Filani kundërshton Dobrica Qosiqin, i cili kërkoi nga shkrimtarët e Kosovës që të nisin të krijojnë letërsinë nga fillimi, në frymën e patriotizmit socialist-jugosllav.

- Ditën e arrestimit, ditët e para në burg, marrjet në pyetje, gjykimin, lirimin etj.

Adem Demaçi ishte figura kryesore e lëvizjes kombëtare për rreth gjysmë shekulli, prandaj autobiografia e tij dëshmon për një kohë, për ngjarje dhe njerëz. Ai ishte njeriu më i lirë i kohës në kuptimin e lirisë mendore

dhe shpirtërore, prandaj përfaqësonte mendimet e hapura ose edhe të palthëna të shqiptarëve që nuk pajtoheshin me pushtimin.

Fati i Adem Demaçit, situatat dhe ngjarjet nëpër të cilat ai kaloi nuk mund të ndahen nga fati i popullit të tij, prandaj funksioni dëshmues i romanit, krahas vlerës artistike, është jashtëzakonisht i rëndësishëm.

Kur flasim për raportin mes dokumentit dhe artit, duhet të theksohet se në *Dashuria kuantike e Filanit*, "... duke qenë roman autobiografik, të gjitha janë të vërteta"<sup>7</sup>. Fjala është për personazhet, ndodhitë dhe sfondin e tyre, idetë etj. Natyrisht, vetëkuptohet se në letërsi vërtetësia gërshetohet me fikcionin.

Sipas dr. Xhonsonit "... askush nuk është më i kualifikuar për të shkruar për jetën e tij se sa vetvetja..."<sup>8</sup>. Megjithatë, një mendim i tillë është i debatueshëm, sepse kujtimet, veçanërisht ato të fëmijërisë, mund të mos jenë të besueshme. Sidoqoftë, Adem Demaçi rrëfen edhe për mendimet dhe përjetimet e tij brenda mureve të burgut, të cilat askush nuk mund t'i përjetësonte më mirë se ai.

**Stili.** *Dashuria kuantike e Filanit* karakterizohet nga stili lakonik. Duke u përqendruar në ngjarje të përzgjedhura dhe në situata ose momente të këtyre ngjarjeve, autori me pak fjalë thotë shumë. Nuk ka rrëfime, përshkrime ose meditime që zënë shumë vend në tekst.

Në të shumtën e herëve, kur një tregim flet për një personazh, autori bën një portretizim të shkurtër të tij; rrëfen shkurt për një situatë për të vazhduar me dialogun me personazhin në fjalë.

Përshkrimi, rrëfimi dhe dialogu nuk karakterizohen nga proliksiteti.

*Dashuria kuantike e filanit* karakterizohet nga ligjërimi personal (në letrat elektronike); nga diskursi filozofik (kur autori mediton për jetën, botën); nga diskursi eseistik (rrëfimi i ngjarjeve që lidhen me historinë).

Në disa tregime ligjërimi është telegrafik:

Harrove cilët ishin ata që e lanë Drenicën në gjak? Harrove krimin e Tivarit? Harrove krimet e Shalës, të Ferizajt, të Gjilanit? Harrove "strelishtën" e Prishtinës? Harrove gjykimet e Ali Shukriut? Harrove gratë e veja dhe mocanikët e tu që u rritën jetimë? Harrove shpërnguljen e dhunshme që s'u ndal kurrë?<sup>9</sup>

<sup>7</sup> Bajram Kosumi, *Letërsia nga burgu kapitull më vetë në letërsinë shqipe*, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup, Shkup, 2020. f. 134.

<sup>8</sup> J. A. Cuddon. *Literary terms & literary theory*, Penguin Books, London, 1999, f. 63.

<sup>9</sup> Adem Demaçi, *Dashuria kuantike e Filanit*, "Gjon Buzuku", Prishtinë, 2007, f. 89.

Me fjali të shkurta dhe stil telegrafik jepen shumë informacione që janë në funksion të rrëfimit, të dinamizimit të tij, por edhe të emocionalitetit të tekstit.

Në dialogë me të afërm, ose edhe më të burgosurit, jo rrallë, hasim shprehje popullore, të cilat i japin rrëfimit ngjyrim të stilit popullor. Ky ngjyrim spikat edhe përmes thënieve popullore ose edhe mallkimeve:

- Faroji, o Zot, këta dushmanë! – mallkoi nëna dhe shprushi zjarrin në votër...<sup>10</sup>

- He, vrafshi veten! Të mallkuar! – mallkonte nëna...<sup>11</sup>

Stili popullor i të rrëfyerit karakterizon dialogët dhe rrëfimet e personazheve të moshuara.

Në tekst hasim edhe një numër të konsiderueshëm të fjalëve që janë përdorur në kohën e rinisë së autorit, të cilat sot pothuaj nuk i dëgjojmë, si: fucak, kanac, gavetë, gjezëmti, muftak, çmistim, sapllak, tërvësë, fostujë etj.

*Dashuria kuantike e filanit* karakterizohet nga larushia e ligjërit, e cila kushtëzohet nga situatat që rrëfohen. Kjo e pasuron rrëfimin dhe shmang mundësinë që lexuesi të lodhet nga rrëfimi i njëtrajtshëm.

**Personazhet.** Jeta e Filanit lidh të dy pjesët e romanit dhe të gjitha tregimet mes vete. Ai është i vetmi personazh që ndërtohet plotësisht: njohim fëmijërinë e tij, rininë dhe pjekurinë. Filanin e shohim si fëmijë, si nxënës të shkollës fillore, si nxënës të shkollës së mesme, si student, si të punësuar dhe si të burgosur; e shohim në raport me nënën, vëllain, dajën, shokët e klasës, mësimdhënësit, shkrimtarët, hetuesit; e njohim nga raporti me të tjerët, si dhe nga rrëfimi për vetveten; e njohim nga raporti i tij me botën dhe me vetveten. Tregimet e shpërfaqin në raport me idealin e tij për lirinë, ndërkaq letrat elektronike në raport me dashurinë.

Filani është personazh i veprimit, por edhe personazh që përsiat; i krijon situatat, por edhe ndodhet në to; i bën të qarta shkaqet e veprimeve, si dhe pasojat e veprimeve të tij; ka dramë të brendshme dhe të jashtme; flet për veten dhe me veten; fillimisht na befason me veprimet e tij, të cilave u mbetet besnik; i ka në pajtueshmëri të plotë mendimet dhe veprimet.

Personazhet tjera janë episodike. Lidhen me një situatë të caktuar dhe mund të përmenden vetëm në një tregim ose në disa sosh. Megjithëkëtë,

<sup>10</sup> Po aty, f. 34.

<sup>11</sup> Po aty, f. 35.

disa nga to i mbeten në kujtesë lexuesit, si: Nëna e Filanit, Abeja (vëllai i Filanit), Osman Çausi, profesor Zekeria Rexha etj.

Të gjitha personazhet janë në funksion të rrëfimit, në funksion të dëshmisë për një kohë.

**Përgjithësimi i situatave.** Shumica e situatave që rrëfihen janë përzgjedhur edhe sipas një kriteri: janë përsëritur shpesh në jetën e popullit shqiptar.

Tregimi lidhur me rastin e hyrjes së partizanëve në Prishtinë, një prej dëshmimeve më të mira për këtë ngjarje, përqendrohet në oborrin e familjes së Filanit. Sjellja e partizanëve-çetnikë në oborrin e tij flet për mënyrën e sjelljes së tyre me të gjitha familjet shqiptare. Në pajtim me qëllimin e tij, autori përmes një ngjarje flet për një dukuri.

Tregimi lidhur me fjalimin e Dobrica Qosiqit dhe kërkesën e tij nga shkrimtarët shqiptarë, si dhe reagimin e të pranishmëve, paraqet një situatë që është përsëritur në vazhdimësi; paraqet një kërkesë të shndërruar në politikë.

Mënyra e arrestimit të Filanit është pak a shumë forma se si ka reaguar UDB-ja. Marrja në pyetje në hetuesi, pavarësisht se lidhet me situata konkrete, flet për mënyrën e trajtimit të të arrestuarve nga sigurimi shtetëror.

Vizita e nënës në burg është ngjarje që flet për të gjitha nënat që kanë vizituar bijtë e tyre në burgje. Atmosfera e kësaj vizite pasqyron atmosferën e vizitave të tilla.

Qëndrimi në vetmi dhe në dhomat e të burgosurve i japin lexuesit idenë e jetës, vuajtjeve, urisë dhe kushteve të tmerrshme në të cilat kanë jetuar të burgosurit.

Pothuaj çdo situatë flet për një dukuri, prandaj edhe situatat krejtësisht personale kanë edhe karakter përgjithësues. Si i tillë, romani është dëshmi për jetën e një njeriu, por edhe dëshmi për një kohë.

**Nëntë letrat elektronike.** Në letrat elektronike, të cilat kanë pothuaj ton familjar, ndihet afërsia e letërshkruesit me atë që i dërgohen letrat. Funksioni i tyre: Filani do që Dardha ta njohë më mirë para se ajo ta marrë vendimin që të jetë gjysma e dytë e tij.

Pavarësisht raportit të tij me Dardhën letrat nuk karakterizohen me tonin dhe fjalësin që zakonisht i hasim në letrat që i dashuruari ia dërgon të dashurës, sepse Filani nuk ka për qëllim ta bindë Dardhën se duhet të jenë bashkë në jetë. Ai rrëfen. Ajo duhet t'i nxjerrë përfundimet.

Deri sa tregimet lidhen me të kaluarën, letrat lidhen me të tashmen dhe potencialisht me të ardhmen. E tashmja lidhet me vendin ku jeton Fi-

lani, me metatekstin lidhur me librin që po shkruan, si dhe me mendimet e tij për raportin me jetën dhe Dardhën. Në letrat njohim të tashmen, ndërkaq në tregimet të kaluarën e tij.

Letrat karakterizohen nga shpjegimet, analizat, konstatimet, përgjithësimet. Rrallë në to futet edhe ndonjë kujtim. Ato përplotësojnë personazhin, i cili në tregime flet për sakrificën për atdheun, ndërsa në letra për sakrificën për dashurinë. E për dashurinë Filani do të vuajë i vetëm, sepse mikes së tij "...e cila nuk dëshiron ta lërë vetëm, meqenëse ai është në kërkim të gjysmëpjesës së shpirtit, që i mungon..."<sup>12</sup>, ia mohon bashkëvuajtjen.

Filani pati dy ideale. Që të dyja i preku, por asnjëri nuk iu përmbush plotësisht.

## Përfundim

*Dashuria kuantike e Filanit* është roman autobiografik lidhur me jetën e njërit prej personaliteteve më të rëndësishme të botës shqiptare të gjysmës së dytë të shekullit XX.

Duke qenë se autori është pjesëmarrës i ngjarjeve, atëherë roli dëshmues i romanit është i rëndësishëm së veçantë. Në letërsinë shqipe nuk ka roman tjetër që jep më mirë situatën në Kosovë pas Luftës së Dytë Botërore.

Narratori i rrëfen ngjarjet me "kapërcime". Ai përqendrohet në ngjarje të cilat i përzgjedh për nga ndikimi që kanë pasur në kujtesën e tij, si dhe për nga pesha e tyre në jetën e popullit.

Romani ndahet në dy pjesë: letrat elektronike dërguar Dardhës dhe tregimet.

Në *Dashuria kuantike e Filanit* defilojnë emra të shumtë, personazhe të shumta me të cilat e ka ndeshur jeta Filanin, por ka vetëm një personazh që ndërtohet plotësisht. Pavarësisht kësaj, disa nga to, edhe pse episodike, mbeten gjatë në kujtesën e lexuesit.

Ngjarjet dhe situatat kanë edhe karakter përgjithësues. Ato nuk ndikojnë vetëm në jetën e Filanit, por edhe në jetën e gjithë popullit.

Dialogu është përbërës i rëndësishëm i tekstit. Në shumë tregime kemi "ballafaqimin" e Filanit me një personazh. Situatat e tilla karakterizohen nga dialogët, të cilët janë në funksion të karakterizimit të personazheve,

<sup>12</sup> Abdullah Konushevcu, *Demaçi*, Nositi, Prishtinë, 2008, f. 104.

por edhe në funksion të dëshmisë për një kohë. Dialogët me të shpeshtë kanë formën pyetje-përgjigje.

Larushia e rrëfimit e veçon romanin *Dashuria kuantike e Filanit*. Situatat e ndryshme, takimi me njerëz të profileve të ndryshme bëjnë që rrëfimi, por edhe dialogu, të kenë tonin, ngjyrimin dhe diskursin që reflektojnë situatat, ngjarjet dhe atmosferën e përgjithshme.

Në *Dashuria kuantike e Filanit* njohim edhe botën e brendshme të njeriut që nuk ka fshehur veprimet dhe mendimet e tij. Të rralla janë personalitetet sikur Adem Demaçi që, gjatë gjithë jetës, i kanë pasur në pajtueshmëri të plotë fjalën dhe veprimin.

Si roman për një njeri të jashtëzakonshëm dhe për një kohë jo të zakonshme; si roman me vlerë artistike dhe dëshmuese, *Dashuria kuantike e Filanit* do të duhej të përfshihej në planprogramet e shkollave në mënyrë që nxënësit dhe studentët, përmes artit, të njohin një periudhë të rëndësishme në jetën e popullit shqiptar dhe, pse jo, ta njohin njërën prej figurave më të veçanta dhe më të rëndësishme të kombit.

Pavarësisht se vepra letrare analizohet shkoqur nga emri i autorit të saj, emri i Adem Demaçit gjithnjë do të jetë në mendjen e lexuesit sa herë që do të lexohet Adem Dema.

## Literatura

Cuddon, J.A., *Literary terms & literary theory*, Penguin Books, London, 1999.

Demaçi, Adem, *Dashuria kuantike e Filanit*, Gjon Buzuku, Prishtinë, 2007.

Dykro, Osvald, Todorov, Cvetan, *Fjalor i shkencave të ligjërit*, Rilindja, Prishtinë, 1984.

Konushevcu, Abdullah, *Demaçi, Nositi*, Prishtinë, 2008.

Kosumi, Bajram, *Letërsia nga burgu kapitull më vetë në letërsinë shqipe*, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup, Shkup, 2020.

*Romani "Gjarpijtë e gjakut" i Adem Demaçit*, (Artikuj të zgjedhur letrarë nga Abdullah Konushevcu), Nositi, Prishtinë, 2011.

## ADEM DEMA FOR ADEM DEMAÇI

### Summary

*Filan's Quantum Love* is a biographical novel about the life of one of the most important personalities of the Albanian world of the 20th century.

Since the author is a participant in the events then the witnessing role of the novel is of particular importance. There is no other novel in Albanian literature that gives a better description of the situation in Kosovo after the Second World War.

The narrator recounts the events by skipping some of them. He focuses on the events, which he selects for the impact they have had on his memory as well as their weight in people's lives.

The structure of the novel allows the author to say a lot in a few words. The novel is divided into two parts: the electronic letters sent to Dardha and the stories that tell about Filan's life. The first part deals with Filan's present, and the stories with his past.

There are many names in the novel, many characters that Filan's life has encountered, but there is only one character that is completely constructed. Despite this some characters, though episodic, remain long in the reader's memory.

The events and situations that are narrated in the novel have a general character as well. They affect not only Filan's life, but also the lives of all the people.

Dialogue is an important component of the text. In many stories we have Filan's "confrontation" with a character. Such situations are characterized by dialogues, which are in function of defining of the characters, but also in function of testimony for a while. The most frequent dialogues are in the form of questions-answers.

The variety of narrative perspectives sets *Filan's Quantum Love* apart. Different situations, meeting people of different profiles make the story, but also the dialogue to have the tone, color and discourse that reflects the situations, events and the general atmosphere.

In *Filan's Quantum Love* we also know the inner world of the man who has not hidden his actions and thoughts. Rare are personalities like Adem Demaçi who, throughout their lives, have had in full compliance the word and the action.

As a novel about an extraordinary man and about an unusual time; as a novel of artistic and evidential value *Filan's Quantum Love* should be included in school curricula so that pupils and students, through art, recognize an important period in the life of the Albanian people and, why not, recognize one of the most special and important figures of the nation.

Despite the fact that the literary work is analyzed separately from the name of its author, the name of Adem Demaçi will always be in the mind of the reader whenever Adem Dema is read.